



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5kaProt

Himarë, më 01.02.2022

VENDIM

Nr. 6 datë 28.01.2022

PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR  
Nga fondet e Bashkisë

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të pikës 5, të nenit 15, dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr.121 datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Në mbështetje të vendimit Nr. 518 datë 4.9.2018 Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.

Në mbështetje të V.K.M 518 datë 4.9.2018 kreu II pika b) ku përfshihet shërbimi në familje. pika 4, Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe për persona që janë me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe mund të ndihmohen nga kujdestari apo ndihmësi personal; Sipas projektvendimit të paraqitur nga drejtoria e integritetit dhe zhvillimit ekonomik e social për vendosjen e ndihmësive personal për familjet me nevoja ekstreme nga fondet e buxhetit vendor Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28.01.2022.

VENDOSI

*Përcaktimin e shërbimit në shtëpi (kujdestar ligjor), sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të Vendimit 518 datë 04.09.2018, për zonjën Marjana Godo Xhaferi e datëlindjes 04.02.1965 me nr personal G55204135B banore në fshatin Sasaj, e cila ka probleme mendore është shtruar disa herë në spitalin psiqiatrik Vlorë, është e braktisur nga familjarët dhe ndodhet në situatë rruge. Për familjen e Agron Nexhip Dervishi dhe Blerina Nexhip Dervishi banor në fshatin Qazim Pali Nj. Administrative Lukovë përfitues të statusit të para-tetraplegjikut të cilët janë në kujdestarinë e dy prindërve të mushuar dhe me probleme të rënda shëndetësore, në pamundësi për tu shërbyer fëmijve të tyre, të cilët janë në një moshë madhore i kërkohet mbështetje financiare Bashkisë për të vendosur një kujdestar ligjor për të dy fëmijët Blerina dhe Agron Dervishi.*

-Masa e përfitimit të kujdestarëve ligjor të jetë në shumën 10.000 lekë në muaj. Kjo shumë duhet të jepet për periudhën **1 Janar – 31 Dhjetor 2022** dhe do të përdoret fondi nga buxheti i Bashkisë. Ngarkohet administrata e Bashkisë.

Vota pro 12.  
Vota kundra 0.  
Vota abstenim 0.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elena Memushaj



KRYETARI I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj